

MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për Lotin III: "Shërbim pastrimi për QSUT", me fond limit 4,339,383 (katër milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, me numër reference të Lotit III: REF-63371-04-18-2018

Drejtuar:

Operatorit ekonomik: "Ante Group" SHPK me NIPT J62904100D, adresa: Lagjja "22 Tetori", Rruga; "Antipatrea" Berat.

* * *

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur, me objekt; "Shërbim pastrimi" e ndarë në 4 (katër) lote si më poshtë:

- Loti I "Shërbim pastrimi për Departamentin e Administratës Publike",
- Loti II: "Shërbim pastrimi për Spitalin Universitar te Traumës"
- Loti III: "Shërbim pastrimi për QSUT"
- Loti IV: "Shërbim pastrimi për Shkollën e Administratës Publike".

Numri i referencës së procedurës: **REF-63364-04-18-2018**

Numri referencës të Lotit III: **REF-63371-04-18-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Shërbim pastrimi" e ndarë në 4 (katër) lote, me fond limit total fondit 92,859,618 (nëntëdhjetë e dy milion e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [23 Prill 2018] [Numri 16]
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

Për Lotin III: "Shërbim pastrimi për QSUT", me fond limit 4,339,383 (katër milion e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH:

1- ANTE -GROUP SHPK	J62904100D
Emri i plotë i shoqërisë	numri i NIPT-it

Vlera : 3.818.913 (tre milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) lekë (pa TVSH)

- 2- FUSHA SHPK J61922018S
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera: 4.172.004 (katër milion e njëqindeshtatëdhjetë dymijë e katër) Lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)
- 3- CLEAN FAST SHPK L61807037R
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it
Vlera: 3.363.434,2 (tre milion e treqindëgjashtëdhjetë tremijë e katërqindetridhjetekatër presje dy) Lekë (pa TVSH)

Janë s kualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

- 1- CLEAN FAST SHPK, me NIPT L61807037R dhe vlerë të ofertuar: 3.363.434,2 (tremilion e treqindëgjashtëdhjetë tremijë e katërqindetridhjetekatër presje dy) Lekë (pa TVSH)

Arsyet e s kualifikimit:

Ofertuesi nuk ka arritur të përmbushë kriterin e disponueshmërisë së një makine për larjen e rrugëve (autobot), kriter ky i përcaktuar në pikën 2.6 “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike (makineri dhe pajisje) që nevojiten për ekzekutimin e kontratës ...”, të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim të DT. Ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet e përcaktuar në “Shënim” të pikës 2.6 të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim të DT, për të provuar pasjen në pronësi ose me qera të kësaj makine. Sqarojmë se përveçse një kriter i veçantë kualifikimi, disponueshmëria e kësaj makine është e domosdoshme për të përmbushur objektin e kontratës, mirëmbajtja dhe pastrimi i rrjetit rrugor dhe shesheve në QSUT (larje e rrjetit kryesor rrugor me makinë teknologjike, larje e shesheve, shesheve të parkingut të QSUT-së, larja e rrjetit rrugor dhe shesheve me ujë me presion, etj).

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**Ante Group**” SHPK me NIPT **J62904100D**, adresa: Lagjia “22 Tetori”, Rruga; “Antipatrea” Berat, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 3,818,913 (tre milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) lekë, vlera pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”**, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, menjëherë nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 08.06.2018
Ankesa: JO